



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.01.2024

MBLEDHJA Nr. 1,
Datë 22.01.2024, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 22.01.2024, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 1 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin dhjetor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë.
3. Mbi shqyrtimin e kërkesës për shtyrje të afatit të derogimit të shoqërisë Kalisi Hydropower sh.p.k.
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW”, i ndryshuar.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, për dhënien e autorizimit nga ERE shoqërisë “TRUEN” shpk për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI